



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2375/6 prot.

Tiranë më 27.12.2024

**REKOMANDIM**

**Nr. 41, datë 27.12.2024**

**PËR KONTROLLUESIN “FINMAN HOSPITALITY SHPK – TIRANA**  
**MARRIOTT HOTEL”**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Finman Hospitality SHPK – Tirana Marriott Hotel*” (në vijim, “*Kontrolluesi*),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 191, datë 08.11.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me M32024022I, me objekt të veprimtarisë si: Hapja dhe menaxhimi i hoteleve “Strukturë Akomoduese 4 ose 5 yje”, e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitet hotelier, hapja

dhe menaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier, hapja, menaxhimi dhe funksionimi i qendrave të rekreacionit, fitness dhe pishina, etj.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë “*klientë*”, “*punonjës aktual*”, “*punonjës të larguar*”, “*vizitorë*”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi administron dokumentacionin e grumbulluar për punonjësit aktual dhe për punonjësit e larguar, në arkivën fizike, të tilla si:
  - Dosje të punonjësit aktual (*Udhëzues për punonjësin, kontratë pune, politika për ngacmimin dhe sjelljen profesionale, Information Protection Agreement, librezë shëndeti, librezë pune, vërtetim i aftë për punë, Formular i plotësuar nga punonjësi me të dhëna, dëshmi penalteti*);
  - Dosje të punonjësit të larguar (*Vendim për zgjidhje kontrate, dëshmi penalteti, diplomë, kontratë, politika për ngacmimin dhe sjelljen profesionale, Information Protection Agreement, librezë shëndeti, Formular i plotësuar nga punonjësi me të dhëna, nr. llogari bankare, udhëzues për punonjësin, separation payment*);

Konstatohet se Kontrolluesi në Formularin e plotësuar nga punonjësi mbledh ndër të tjera të dhëna për “Kontaktet Emergjente” të tilla si “emër, marrëdhënia me punonjësin, adresa, nr. tel”, si dhe sa pjesëtar familje janë dhe statusi (beqar/i martuar/etj.), në kundërshtim këto me parimin e mjaftueshmërisë sipas germës “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kategoritë e të dhënave të mbledhura/ruajtura, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, si dhe mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Gjithashtu, dosja e punonjësve të larguar ruhet nga Kontrolluesi, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes këtyre të dhënave në kundërshtim me germën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

3. Kontrolluesi disponon një sistem video-survejimi CCTV për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të hotelit. Konstatohet se Kontrolluesi disponon tabelë informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit, por nuk

është sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar.

4. Kontrolluesi gjatë regjistrimit të klientit në sistem, gjeneron një dokument lidhur me të dhënat që mblidhen për rezervimin.

Në këtë dokument konstatohet se informimi i subjekteve të të dhënave është vetëm në gjuhën angleze. Pra, Kontrolluesi nuk informon në gjuhën shqipe subjektet e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave të tij, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale në gjuhën shqipe, është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

5. Kontrolluesi, për sistemin e video survejimit CCTV, vendosi në dispozicion dokumentin “*Kontratë Nënshpërmarrje*” midis ALB-STAR shpk me NIPT J62903512W dhe Global Net shpk me NIPT L02205042V.

Sqarojmë se, nga analizimi i ekstraktit të QKB, në datë 29.08.2024 janë kryer ndryshimet si: “është shtuar ortakut Finman dhe është larguar ortakut ALB-STAR”. Gjithashtu në datë 21.10.2024 janë kryer ndryshimet si: “emri i subjektit/emri tregtar, ishte Arena Hotel u bë Finman Hospitality”.

Referuar ndryshimeve të mësipërme, konstatohet se Finman Hospitality, ka përthithur të gjithë detyrimet që ka pasur subjekti ALB-STAR shpk.

Nga analizimi i kontratës së sipërcituar rezulton se nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në*

*rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit.

6. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Megjithatë, pas marrjes në dijeni për fillimin e hetimit administrativ kontrolluesi ka depozituar Formularin e Njoftimit, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Nga analiza e këtij “Njoftimi”, konstatohet se ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- Deklarimi në rubrikën nr. 4, Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen: “P.Sh. Identitetet e familjarëve” etj;
- Deklarimi në rubrikën nr. 7.2.1, Subjekti Marrës: “P.Sh. Banka” etj.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

7. Kontrolluesi nuk ka hartuar Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike (mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në

zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi disponon një grup politikash të miratuara nga Marriott Group e cila përfshin Marriott International INC dhe filialeve Marriott, lidhur me sigurinë e informacionit. Konkretisht disponon:
- Guest Data Protection: Handling of passport and government issued document;
  - Guest Data Protection: Security of confidential and personally identifiable information;
  - Handling guest requests for data erasure;
  - How to retrieve and remove guest personal data when requested;
  - Privacy center;
  - Marriott data privacy framework guest privacy statement;
  - HR Policies & Compliance;
  - Marriott data privacy framework HR data privacy statement;
  - Applicant privacy statement;
  - Global privacy policy;
  - Vërtetim trajnimi;
  - Information Protection Agreement.

Rezulton se, mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si, “Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale”, “Kontrollin e sigurisë së sistemit të arkivimit të të dhënave personale”, “Analiza e riskut është pjesë përbërëse e PSI-së”, “Hapat që duhet të ndërmerren në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Konstatohet se, masat e ndërmarra janë jo të plota në raport me veprimtarinë e gjerë që kryen Kontrolluesi, sikurse edhe grupi i politikave që disponon, nuk aplikohen dhe dokumentohen gjatë ushtrimit të aktivitetit, pasi ky set politikash i atribuohet kompanisë globale Marriott Group që gjendet në faqen e internetit [www.marriott.com](http://www.marriott.com) dhe nuk parashikojnë proceset përpunuese që kryhen nga Tirana Marriott Hotel.

Gjithashtu, konstatohet mosplotësimi i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”), për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa sa i përket trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në kuadër të politikave të grupit. Nga verifikimi i prezantimeve trajnuese, rezulton se në përmbajtje të tyre nuk i referohen legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në

kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimit nr. 48”) si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 2375/4 prot., datë 13.12.2024.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancën dëgjimore datë 20.12.2024, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar duke vendosur në dispozicion, formularin e njoftimit, tabelën e informimit sipas Udhëzimit nr. 3, etj.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, si dhe dokumentin e gjeneruar nga sistemi e cila informon klientët në gjuhën shqipe.

Lidhur me Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të saj vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (*psh., masat e sigurisë lidhur me të dhënat sensitive, masat e marra lidhur me transferimin e të dhënave, kategoritë e të*

dhënave që transferohen, etj.), afatet e mbajtjes së të dhënave (psh. për klientët e hotelit), etj. Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 5 të Ligjit, të marrë masa që mbledhja e të dhënave personale nga ana e tij, të kryhet në mënyrë të ligjshme, informacioni të grumbullohet vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me këto qëllime, duke ju përmbajtur gjithashtu parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar kontratën me përpunuesin duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
5. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të kryej përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, etj.;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që

kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;

8. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
- (i) menjëherë, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 2 më sipër
  - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
  - (iii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikë 3 më sipër;
  - (iv) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 4 më sipër;
  - (v) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 6 dhe 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
10. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 27.12.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**